



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
BORDI DISIPLINOR

Nr. (•)i Vendimit

VENDIM
BORDI DISIPLINOR

i përbërë nga:

Jonida Gaba:	Kryetare
Entela Memishaj Shehaj:	Sekretar/ Anëtar
Marjana Semini-Tutulani:	Anëtar
Irena Laha:	Anëtar
Merita Prifti:	Anëtar

Në seancat e datës (•)dhe (•)mori në shqyrtim kërkesën e Ministrisë së Drejtësisë mbështetur në Urdhërin Nr. (•), datë (•)të Ministrit të Drejtësisë “Për nisjen e procedimit disiplinor për noterin (•)”, përcjellë pranë Bordit Disiplinor me shkresën Nr. (•)Prot., datë (•)të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë, me të dhënat si më poshtë:

KËRKUES:	Ministria e Drejtësisë
DREJTUAR:	Bordi Disiplinor, Dhoma Kombëtare e Noterisë
KUNDËR:	Subjektit të Procedimit (•), Noter
OBJEKTI:	Nisja e procedimit disiplinor për noterin(•); Marrjen e masës disiplinore të përcaktuar në gërmën dh) të nenit 26 të Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë”
BAZA LIGJORE:	Neni 26, nenet 43-55 të Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë”

BORDI DISIPLINOR

pasi dëgjoi relatimin e anëtares znj. (•),në përfundim tëseancave dëgjimore me subjektin e procedimit disiplinor, Noterin z.(•), në prani të përfaqësuesessë Ministrisë së Drejtësisë, Znj. (•), Drejtore e Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore tëÇështjeve të Drejtësisë dhe, pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

A. FAKTET

1. Pranë Bordi Disiplinor të Dhomës Kombëtare të Noterisë (“**Bordi**”) është depozituar me shkresën Nr. (•)Prot., datë (•), të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë, Urdhri Nr. (•), datë (•)i Ministrit të Drejtësisë “Për nisjen e procedimit disiplinor për noterin (•)”.
2. Me shkresën nr. (•)Prot., datë (•)të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë për “Dërgim dokumentacioni”, është dërguar pranë Bordit, raporti Nr. (•), datë (•) “Raport për kryerjen e kontrollit në zyrën noteriale të noterit publike (•)”, bashkë me dosjen e plotë hetimore.

3. Me shkresën me datë (•), noteri është njoftuar për zhvillimin e seancës dëgjimore me Bordin Disiplinor më datë (•).
4. Me kërkesën me datë (•), noteri ka kërkuar shtyrjen e seancës dëgjimore për të pasur më shumë kohë për studimin e dosjes hetimore dhe përgatitjen e mbrojtjes. Kjo kërkesë u pranua nga Bordi, i cili caktoi seancën dëgjimore më datë (•).
5. Në vijim, me tre kërkesa të njëpasnjëshme, noteri ka kërkuar në vazhdim shtyrjen e seancave dëgjimore të caktuara nga Bordi Disiplinor, respektivisht, më datat (•), (•) dhe (•), bazuar në raportet mjekësore të mëposhtme:
 - a) Raport lëshuar nga mjeku (•), Instituti Shëndetësor (•), nr. regjistri (•), dt. (•), diagnozë *status febrili* (3 ditë pushim).
 - b) Raport lëshuar nga mjeku kardiolog (•), Instituti Shëndetësor (•), nr. regjistri (•), dt. (•), diagnoza H.T.A. (3 ditë pushim);
 - c) Raport lëshuar nga mjekja (•), Institutit Shëndetësor (•), nr. regjistri (•), dt. (•), diagnozë Bronkopneumoni dextra (14 ditë pushim);

Në të paktën një rast, rezultoi e provuar se noteri kishte ushtruar veprimtari noteriale dhe përpiluar akte gjatë periudhës së pamundësisë shëndetësore sipas raporteve të mësipërme.

6. Në seancën dëgjimore të caktuar më datë (•), ora (•), u paraqit avokati mbrojtës i noterit, Av. (•), i autorizuar sipas prokurës së posaçme të lëshuar në të njëjtën datë, i cili kërkoi shtyrjen e seancës për t'u njohur me aktet. Kërkesa u pranua dhe seanca u shty më datë (•), ora (•).
7. Në seancën dëgjimore të zhvilluar më datë (•), ora (•), pas parashtrimit të argumentave mbrojtëse të tij, avokati ngriti dyshime mbi origjinalitetin e nënshkrimit të njërit prej anëtarëve të grupit të inspektimit të Ministrisë së Drejtësisë në dokumentin me Nr. (•)prot., datë (•) "Për kryerjen e kontrollit në zyrën noteriale të noterit (•)".
8. Në të njëjtën seancë, avokati i noterit pretendoi se noteri e aplikonte vendosjen e pullës në faqen e pasme të aktit noterial respektiv që përpilonte dhe depozitoi si provë, në mbështetje të argumentave mbrojtës, edhe kopje të disa akteve noteriale që vërtetonin aplikimin e pullës. Për pasojë, bazuar edhe në kërkesat e palëve, Bordi vendosi të shtyjë seancën dëgjimore më datë (•), ora (•), për të administruar si prova shtesë lidhur me pretendimet e mësipërme: (i) dëshminë e nëpunësit të MD lidhur me nënshkrimin e vendosur në dokument dhe (ii) marrjen e kopjeve të akteve noteriale nga Regjistri Noterial Shqiptar (RNSH) për verifikimin e aplikimit të pullës në aktet e hedhura në këtë regjistër.
9. Në seancën e datës (•), ora (•), u morën nga Bordi provat sipas pikës 8 më sipër: fillimisht, dëshmia e nëpunësit të MD, z. (•), i cili deklaroi se nënshkrimet në të gjitha aktet e depozituara në dosjen e përcjellë nga MD janë të tijat dhe se ai aplikon, rast pas rasti, nënshkrimin ose siglën e tij. Më tej, kopje të akteve noteriale në gjendjen e hedhur në RNSH nga noteri. Pas marrjes së provave, si më sipër, në të njëjtën seancë, përfaqësuesi i subjektit kërkoi pezullimin e procedimit disiplinor përpara Bordit, duke depozituar për këtë qëllim përpara Bordit kopje të një kallëzimi penal ndaj nëpunësit të MD, z. (•), për falsifikim të firmës. Kallëzimi penal mbante vulën e zyrës së prokurorisë të së njëjtës ditë, (•). Me vendim të ndërmjetëm të marrë në dhomë këshillimi, në të njëjtën ditë, Bordi Disiplinor rrëzoi kërkesën për pezullimin e procedimit disiplinor, bazuar në nenet 50 dhe 32 të Ligjit Nr. 110/2018 "Për Noterinë", në kushtet kur nuk u provuan shkaqe ligjore për pezullimin. Shkak për pezullimin e hetimit dhe procedimit disiplinor, sipas neneve të mësipërme, është ekzistenca e një procesi tjetër, që ka në objektin e tij vërtetimin e faktit dhe që zhvillohet nga një organ tjetër (gjykatë ose prokurori), të cilës me ligj i lejohet mbledhja e provave. Neni 32 i parashikon të tre llojet e proceseve gjyqësore që njeh legjislacioni procedural shqiptar, përfshirë hetimin paraprak dhe gjykimin e veprave penale, të cilat janë në kompetencë të prokurorive dhe gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm, si dhe të prokurorive dhe gjykatave të posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të

organizuar. Procesi gjyqësor që i jep shkak pezullimit të hetimit apo procedimit disiplinor mund të jetë procedim penal në fazën e hetimeve paraprake ose në gjykim. Subjekti i procedimit nuk provoi ekzistencën e një procedimi penal të filluar nga organi i prokurorisë, qoftë edhe në fazën e hetimeve paraprake, në mbështetje të argumentave të tij.

10. Bordi disiplinor vendosi, gjithashtu, të mos pranojë dokumentat shtesë të depozituara nga dëshmitari, nëpunësi z. (•), si dhe dokumentat shtesë të dorëzuara nga përfaqësuesi i subjektit të procedimit, av. (•), bashkarisht me konkluzionet përfundimtare, pas mbylljes së seancës dëgjimore për shqyrtimin e çështjes, më datë 18 maj.

B. MBI HETIMIN DISIPLINOR DHE SHKELJET E PRETENDUARA NGA MINISTRIA E DREJTËSISË

11. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dosjes hetimore, rezultoi se fillimi i hetimit disiplinor ka marrë shkas nga parregullsitë e konstatuara gjatë inspektimit të veprimtarisë së noterit Z. (•), për periudhën 2015-2020, në bazë të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë Nr. (•), datë (•) "Për kryerjen e inspektimit të përgjithshëm pranë noterit (•)".
12. Inspektimi ndaj noterit është kryer në kuadrin e planit vjetor të inspektimit të veprimtarisë së noterëve nga Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë, sipas Urdhrit Nr. 181, datë 15.06.2020, të Ministrit të Drejtësisë "Për miratimin e programit vjetor të inspektimit të noterëve, për vitin 2020". Objekt i inspektimit administrativ rezultoi se ka qenë verifikimi i zbatimit të Ligjit nr. 7829/1994 "Për Noterinë", i ndryshuar (i shfuqizuar), Ligjit nr.110/2018 "Për Noterinë", si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që rregullojnë ushtrimin e veprimtarisë së noterëve, standarteve të sjelljes profesionale, si dhe zbatimin e legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, për periudhën 2015-2020.
13. Nga grupi i kontrollit të Ministrisë së Drejtësisë rezultoi se janë kryer veprimet e hetimit administrativ, si më poshtë vijon:
 - Verifikimi i respektimit të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë Nr.157, datë 02.06.2020, "Për miratimin e kritereve të hollësishme për mjedisin e zyrës së noterit".
 - Verifikimi i kontratës së sigurimit për përgjegjësinë e tij ndaj palëve të treta për shkak të ushtrimit të veprimtarisë noteriale, sipas parashikimit të nenit 65 të Ligjit Nr. 110/2018 "Për Noterinë".
 - Verifikimi i administrimit të regjistrave manualë nga noteri, konform Ligjit Nr.110/2018 "Për Noterinë", si dhe Udhëzimit të Ministrit të Drejtësisë nr.6291, datë 17.8.2005 "Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale, si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale".
 - Verifikimi i respektimit të detyrimit të noterit për hedhjen në sistem të akteve noteriale, në zbatim të VKM-së nr. 304, datë 21.05.2014, "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të shërbimit Noterial Shqiptar, Regjistri Noterial Shqiptar (RNSH)".
 - Verifikimi i respektimit të detyrimit të noterit, në kuadër të Ligjit Nr. 9917, datë 19.05.2008, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit" i ndryshuar.
 - Verifikimi i pagesës së kuotave pranë Dhomës Kombëtare të Noterisë, konform Ligjit Nr. 110/2018 "Për Noterinë".
 - Verifikimi i respektimit të detyrimeve në përpilimin e akteve noteriale konform Ligjit Nr. 110/2018 "Për Noterinë", si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore.
14. **Shkeljet e pretenduara nga Ministria e Drejtësisë.** Në përfundim të analizës ligjore të akteve dhe veprimeve noteriale, grupi i kontrollit ka gjetur shkeljet si vijon:

- 1) Noteri nuk ka përmbushur detyrimet e parashikuara në :
 - a. Nenin 17, pika 4, të Ligjit Nr.110/2018 “Për noterinë”, ku sanksionohet se: “Përpara fillimit të ushtrimit të veprimtarisë, në rastet e ndryshimit të vendndodhjes së zyrës noteriale ose të dhënave të tjera të shënuara në Regjistrin e Noterisë, noteri ose zëvendësnoteri njoftojnë me shkrim Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomën brenda 15 ditëve nga fillimi i veprimtarisë në adresën e re ose ndryshimit të fakteve të përfshira në Regjistrin e Noterisë”;
 - b. Nenin 63, pika 1, gërma “m” të Ligjit Nr. 110/2018 “Për noterinë” ku citohet se: “Noteri, përveç detyrave të tjera të parashikuara në këtë ligj dhe në ligje të veçanta, kryen detyrat e mëposhtme [...] siguron mbajtjen hapur të zyrës noteriale, sipas rregullave të miratuara për këtë qëllim”;
 - c. Nenin 63, pika 3, ku parashikohet se, “Për raste të tjera, kur noteri nuk ka zëvendës dhe mungon më tepër sesa 10 ditë, ai lajmëron me shkrim Dhomën, nga e cila merr konfirmimin e njoftimit”.

Evidentohet në raport se, pavarësisht inspektimit të realizuar nga Ministria e Drejtësisë, nga ana e noterit nuk është paraqitur njoftim mbi ndryshimin e zyrës së tij ku edhe nga verifikimet e kryera në QKB, sërish vendi i aktivitetit rezulton L. (•), (•), ndryshe nga vendodhja e pretenduar e ushtrimit të aktivitetit në (•) dhe në ndryshim me adresat e relatuara në aktet e lëshuara prej tij “Rr. (•)”.

- 2) Noteri nuk ka përmbushur detyrimet e parashikuara sipas nenit 20/2 të Ligjit Nr.110/2018 “Për noterinë” dhe Urdhrit nr. 157, datë 02.06.2020, “Për miratimin e kriterëve të hollësishme për mjedisin e zyrës së noterit”, lidhur me adresën dhe kushtet e zyrës noteriale, pasi:
 - a. Në zyrën noteriale ku ka transferuar aktivitetin noteri, me adresë në aksin (•) – (•), (•), ushtron veprimtarinë edhe i vëllai i noterit me profesion avokat, në kundërshtim me parashikimet e pikës 1 të Urdhrit të sipërcituar.
 - b. Adresa e re e zyrës noteriale nuk i është njoftuar Ministrisë së Drejtësisë, sipas parashikimeve të pikës 3 të Urdhrit të sipërcituar. Mospërmbushja e këtij detyrimi përbën shkelje disiplinore.
- 3) Noteri nuk ka përmbushur detyrimet e parashikuara nga Ligji Nr. 110/2018 “Për Noterinë” dhe Udhëzimi i Ministrit të Drejtësisë Nr. 6291, datë 17.8.2008, “Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale, si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale”, i ndryshuar, lidhur me verifikimin e regjistrit të përgjithshëm të akteve dhe veprimeve noteriale dhe të tarifave përkatëse, pasi:
 - a. Në regjistrin e përgjithshëm të akteve dhe veprimeve noteriale të vitit (•), janë konstatuar numra rendorë të lënë bosh, përkatësisht nga faqja (•) deri në faqen (•).
 - b. Në disa akte noteriale janë realizuar vija që nënkuptojnë emërtimin e aktit të regjistruar si më lart, ndërkohë që plotësimi duhej relatuar i qartë dhe i plotë.
 - c. Disa rubrika janë të plotësuara me shkrim të paqartë.
- 4) Noteri nuk ka përmbushur detyrimet e parashikuara nga Ligji për lidhjen e kontratës për sigurimin e detyrueshëm profesional, gjë e cila përbën shkak për heqjen e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit, sipas pikën 1/g të nenit 21 të Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë”.
- 5) Noteri nuk ka përmbushur detyrimet e parashikuara nga neni 68 i Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë” dhe Udhëzimi i Ministrit të Drejtësisë Nr. 16, datë 30.07.2020, “Për përcaktimin e rregullave për trajtimin e transaksioneve financiare të noterit dhe të fondeve të një klienti ose të një pale të tretë”, pasi u evidentua referuar edhe deklaratës së lëshuar nga ana e tij (nëpërmjet së cilës pretendon se do të hapë llogari në të ardhmen), se nuk kishte llogari të posaçme për

ushtrimin e veprimtarisë së tij si noter dhe as llogari bankare kalimtare. Në pikën 17, të Udhëzimit të Ministrit të Drejtësisë Nr. 16, datë 30.07.2020, “Për përcaktimin e rregullave për trajtimin e transaksioneve financiare të noterit dhe të fondeve të një klienti ose të një pale të tretë”, sanksionohet se “Çdo veprim tjetër i noterit në kundërshtim me këtë udhëzim, konsiderohet shkelje e rëndë dhe përbën shkak për procedimin disiplinor, sipas Ligjit”.

- 6) Noteri nuk ka respektuar detyrimin e parashikuar në nenin 63, gërma “dh”, të Ligjit Nr.110/2018 “Për Noterinë” dhe Udhëzimit nr. 33, datë 29.12.2014 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë dhe Noterisë”, pasi aktet e hartuara prej tij nuk janë të pajisura me pulla.
- 7) Noteri nuk ka respektuar detyrimin në zbatim të VKM-së nr. 304, datë 21.05.2014, “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të shërbimit Noterial Shqiptar, Regjistri Noterial Shqiptar (RNSH)” dhe Urdhërit Nr. 88, datë 4.3.2013, të Ministrit të Drejtësisë “Për përdorimin e Regjistrimit Elektronik Noterial Shqiptar (RNSH)”, duke mos realizuar në kohë dhe në mënyrë korrekte hedhjen në sistemin RNSH të akteve noteriale. Mosregjistrimi i akteve në RNSH brenda afatit (10 ditor) nga ana e noterëve, ose moszbatimi i rregullave të përcaktuara në këtë urdhër përbën shkelje disiplinore në kuptim të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”.
- 8) Noteri nuk ka respektuar detyrimet që rrjedhin nga Ligji Nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar, në bazë të të cilit noterit ka detyrimin për vënien në dispozicion të çdo informacion apo dokument të kërkuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave (DPPPP). Noteri (•) ka mangësi në kryerjen e raportimeve për çdo rast. Nuk janë zbatuar detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, për periudhën 2015-2020. Konkretisht, lidhur me aktet e verifikuara nga grupi i inspektimit evidentohet se noterit duhej të raportonte në DPPPP për aktin Nr. (•) Rep., (•) Kol., datë (•) “Kontratë Hipotekimi” dhe Aktin Nr. (•) Rep., (•) Kol., datë (•) “Kontratë Hipotekimi”.
- 9) Noteri nuk ka respektuar detyrimet që rrjedhin nga Ligji Nr. 110/2018 “Për Noterinë” lidhur me pagesën e kuotave pranë Dhomës Kombëtare të Noterisë për vitet 2018, 2019 dhe 2020.
- 10) Noteri nuk ka respektuar detyrimet që rrjedhin në zbatim të nenit 46 të Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nenit 74 të Ligjit 110/2018 “Për Noterinë”, pasi noterit, jo vetëm që ka detyrim të pashlyera ndaj administratës tatimore për periudhën që ka ushtruar aktivitetin me status aktiv, por nga data (•)rezulton se ka ushtruar veprimtarinë noteriale me status pasiv, duke fshehur të ardhurat dhe duke mos realizuar deklarin e të ardhurave në organet tatimore.
- 11) Noteri nuk ka respektuar detyrimet që rrjedhin nga Ligji nr. 110/2018, “Për Noterinë” në përpilimin e akteve noteriale, pasi janë konstatuar shkelje thelbësore të ligjit në aktet e përzgjedhura nga grupi hetimor (konkretisht, (•) akte/veprime noteriale të marra në zyrën e noterit në mënyrë rastësore të vitit (•) dhe (•) akte/veprime noteriale të viteve (•), (•), (•), (•) dhe (•). Shkeljet e gjetura kanë të bëjnë kryesisht me:
 - a. Faktin që noterit nuk ka marrë masat e nevojshme për të kryer hetim administrativ shtesë, duke u siguruar mbi rezervën ligjore sipas Kodit Civil, në përpilimin e akteve të dëshmisë së trashëgimisë. Testamentit nuk i është bashkëlidhur asnjë certifikatë trangu apo dokumentacion i gjendjes civile për t’u siguruar mbi trashëgimtarët apo rezervën ligjore, sipas nenit 379 të Kodit Civil; kjo përbën shkelje të neneve 348 dhe 372 të Kodit Civil;
 - b. Mos respektimin e dispozitave të parashikuara nga nenet 901 e vijues të Kodit Civil, pasi elementët e prokurës së posaçme hartuar nga ana e noterit përfshijnë gjithashtu përdorimin e mjetit, duke i dhënë tagra të plota administrimi mbi një automjet, duke gabuar në interpretimin dhe emërtimin e prokurës së posaçme;

- c. Mangësi në kryerjen e raportimit të fakteve që mund të përbëjnë dyshim për pastrim parash ose financim terrorizmi;
 - d. Mungesa e bashkëlidhjes së dokumentit të identifikimit të përfaqësuesve në përpilimin e një prokure të posacme, sipas kërkesave të neneve 64, 70 e vijues të KC dhe neneve 63 e 63 të ligjit për Noterinë;
 - e. Mospërputhje të aktit noterial me parashikimet e pikës 3 të Udhëzimit Nr. 232, datë 14.01.2016 “Mbi ndryshimin e pronësisë së mjeteve rrugore”, sa i përket dokumentacionit që dorëzohet për një mjet të parregjistruar në DPSHTRR, në mungesë të certifikatës së pronësisë së shitësit të mjetit;
 - f. Moskryerje e hetimeve mbi pagesat që deklarohen të kryera jashtë zyrës noteriale, në një kontratë shitje automjeti dhe anashkalim i elementëve thelbësorë të kontratës së shitjes sipas nenit 705 e vijues të Kodit Civil;
 - g. Adresa e zyrës noteriale në akte nuk është ajo që rezulton në të dhënat zyrtare të njoftuara nga noteri në QKB dhe DHKN, por edhe e paqartë pasi është shënuar “Rr. (•)”, cka nuk përkon me asnjë rrugë në qytetin e (•) dhe nuk specifikon adresë konkrete në Rrethin (•);
 - h. Mosverifikimi i regjimit pasuror martesor të dhuruesit të pasurisë;
 - i. Lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë, në kundërshtim me parashikimet e nenit 348, prg. 2, i Kodit Civil dhe në kapërcim të kompetencës territoriale për ushtrimin e veprimtarisë noteriale, në kushtet kur shtetasit për të cilët është lëshuar dëshmia janë me vendbanim në Tiranë, ndërsa noteri është licensuar për ushtrim të veprimtarisë në Peshkopi;
 - j. Interpretim i gabuar i kërkesave të Kodit Civil, në përpilimin e një deklarate noteriale për heqjen dorë nga pasuria e llojit ndërtesë në proces legalizimi, e cila ka formën dhe përmbajtjen e kontratës së dhurimit , duke mos marrë në konsideratë faktin se kalimi i pasurisë është realizuar nga poseduesi jo pronar i cili nuk ka fituar të drejtat mbi sendin e paluajtshëm;
 - k. Mungesa e nënshkrimit të palëve në çdo faqe të akteve noteriale;
 - l. Shkelja e Kodit të Familjes në përpilimin e deklaratës noteriale për dhënien e kujdestarisë së fëmijës së mitur;
 - m. Mungesa e bashkëlidhjes së deklaratave noteriale midis hipotekuesit dhe përfituesit në kontratat e hipotekimit;
 - n. Mosverifikim i burimit të të ardhurave të huadhënësve, sipas udhëzimit të MF Nr. 28, dt 31.12.2012;
 - o. Aktet noteriale janë të papajisura me pulla nga ana e noterit;
 - p. Mosraportimi në DPPP i veprimeve të dyshimta për huadhënien e shumave nga huadhënësit lidhur me dy kontrata hipotekimi.
- 12) Në shkresën e DPPP-së Nr.810 Prot., datë 04.09.2020, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me Nr.5419 Prot., datë 04.09.2020 ku janë evidentuar noterët me risk të lartë, rezulton se një prej tyre është dhe noteri (•), i paregjistruar në sistemin e raportimit të DPPP.

C. SHPJEGIMET E NOTERIT LIDHUR ME SHKELJET E KONSTATUARA

Në seancat dëgjimore të zhvilluara me përfaqësuesin e subjektit të procedimit disiplinor, av(•), si dhe në parashtrësat mbrojtësetë paraqitura prej tij pranë Bordit dhe të administruara në dosje, subjekti i procedimit disiplinordha këto shpjegime të përmbledhura lidhur me shkeljet e pretenduara:

- 1) Lidhur me parregullsitë e konstatuara sa i përket adresës së zyrës, shpjegon se: adresa e ushtrimit të veprimtarisë sime noteriale është brenda kufijve territoriale të Degës vendore (•), Bashkia (•), dhe nuk e kam transferuar zyrën asnjëherë jashtë juridiksionit të Bashkisë(•). Ushtrimi i veprimtarisë noteriale për të cilën jam licensuar nuk i përket qytetit, por Bashkisë (•).
- 2) Lidhur me përdorimin e RNSH, noteri shpjegon se RNSH e ka përdorur vazhdimisht. Janë arsye objektive, të cilat janë jashtë kontrollit të noterit që kanë bërë të pamundur që të mos hidhen në sistem të gjitha të dhënat ose të hidhen me vonëse, si defekte, ndërprerje të rrjetit të internetit, energjisë elektrike. VKM Nr. 304 date 21.05.2014 nuk ka karakter detyrues, por shpjegon të drejtën e aksesit. Nuk ka asnjë dispozitë në ligjin për Noterinë ose aktet nënligjore që ta konsiderojë shkelje përsa i përket sistemit.
- 3) Sa i përket mbajtjes së regjistrave të viteve (•)-(•)-(•)-(•) dhe (•), noteri sqaron se : pretendimi për numra rendorë bosh nuk qëndron pasi këto numra u përkasin hapësirave të krijuara nga mbyllja e vitit kalendarik dhe kalimit në vitin pasardhës, pasi me mbylljen e vitit kalendarik lihen dy fletë bosh dhe fillohet me faqe të re.
- 4) Lidhur me kontratën e sigurimit të detyrueshëm, kjo ka ardhur për arsye objektive të shkaktuara nga gjendja e fatkeqësisë natyrore shkaktuar nga COVID-19. Për dëmin eventual që mund të sjell për palët si noter përgjigjem individualisht dhe nuk mund të kushtëzohem domosdoshmërisht nga sigurimi.
- 5) Lidhur me përdorimin e llogarisë kalimtare të noterit, noteri pretendon se Udhëzimi Nr. 16, date 30.07.2020, ka karakter sqarues dhe jo detyrues. Udhëzimi parashikon se vetëm kur e kërkojnë palët të përdorin llogarinë e noterit, mund të procedohet me kërkesë të tyre.
- 6) Lidhur me parregullshmëritë e konstatuara në aktet noteriale të përpiluara dhe përzgjedhura nga grupi i kontrollit, noteri dha shpjegimet përkatëse sipas parashtrimeve (pikat 15-33 të parashtrimeve).
- 7) Noteri pretendon gjithashtu edhe shkelje të procedurave nga ana e Ministrisë së Drejtësisë dhe për pasojë, pavlefshmëri absolute të akteve të kësaj të fundit, sa i përket:
 - (i) inspektimeve të kryera në bazë të Urdhrave Nr. (•), datë (•) dhe (•) datë (•) pasi nuk është vënë në dijeni të Urdhrave dhe Raporteve të kontrollit të hartuar nga MD, dhe raportet e kontrollit janë kryer pa inspektim, jashtë afateve të përcaktuara në Urdhër; dhe
 - (ii) inspektimit të kryer në bazë të Urdhrit nr. (•), datë (•) për shkak se Urdhri dhe Raporti nuk më janë njoftuar në formën dhe afatet e parashikuar nga Ligji, me to jam njohur përmes CD së Bordit, ndërkohë që ndërmjet datës së urdhrit dhe datës së inspektimit, afatet janë aq të ngushta sa nuk lënë hapësirë për njoftim të rregullt të tyre.

D. BAZA LIGJORE.

Shkeljet ligjore të evidentuara nga Raporti Hetimor i Ministrisë janë të mbështetura mbi bazën e mëposhtme ligjore:

- ◊ Ligji Nr.7829 date 1.6.1994 “Për Noterinë”, i ndryshuar (i shfuqizuar);
- ◊ Ligji Nr. 110, date 20.12.2018 “Për Noterinë”;
- ◊ Ligji Nr. 9917/2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”;
- ◊ Ligji Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- ◊ Udhëzimi MD Nr. 6291, datë 17.8.2008 “Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve dhe dokumenteve noteriale si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale”, i ndryshuar;

- ◇ Udhëzimi Nr. 6915, date 30.01.2012, “Mbi procedurat teknike për derdhjen e pagesës se tjetërsimit ne llogarinë bankare të noterit”;
- ◇ Udhëzimi i Ministrit të Drejtësisë Nr. 16, datë 30.07.2020 “Për përcaktimin e rregullave për trajtimin e transaksioneve financiare të noterit dhe të fondeve të një klienti ose të një pale të tretë”;
- ◇ Urdhri i Ministrit të Drejtësisë Nr. 88, datë 4.3.2013 “Për përdorimin e Regjistrat Elektronik Noterial Shqiptar (RNSH)”;
- ◇ Udhëzimi i Ministrit të Financave Nr. 29, datë 31.12.2012 “Për mënyrat dhe procedurat e raportimit të profesioneve të lira jofinanciare” ;
- ◇ Udhëzimi i përbashkët i Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave Nr. 33, datë 29.12.2014 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë dhe Noterisë”;

E. VLERËSIMI I BORDIT

Noteri (•) është licensuar si noter në vitin (•) për të ushtruar veprimtari noteriale në (•). Vlen të saktësohet fakti se në dokumentacionin e regjistrimit si subjekt tregtar (noter) në QKR dhe organet tatimore, noteri rezulton i regjistruar me emrin (•), ndërsa në letërnjoftimin e tij dhe në aktet noteriale, ashtu si edhe në parashtrimet mbrojtëse të paraqitura para Bordit, ai ka nënshkruar si (•). Përfaqësuesi ligjor i tij gjatë seancës dëgjimore konfirmoi se bëhet fjalë për të njëjtin individ /subjekt.

Nga dokumentat e administruara gjatë procedimit disiplinor, konkretisht, ato të paraqitura nga Ministria e Drejtësisë, nga subjekti i procedimit disiplinor si dhe ato të marra kryesisht nga regjistrat / databazat publike, Bordi vlerësoi sa vijon.

Së pari, rezulton seansjë prejakteve noteriale të përpiluara nga noteri dhe të administruara në dosjen hetimore, që referohen viteve 2016 e deri më sot, nuk përmban adresën zyrtare të njoftuar pranë tij pranë Ministrisë së Drejtësisë, Dhomës Kombëtare të Noterisë, Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe organeve tatimore, që është L. (•), (•).

Në të gjitha aktet noteriale të administruara në dosjen hetimore për periudhën (•)-(•) është vendosur një adresë e paqartë, e cila nuk lejon identifikimin e vendndodhjes së zyrës noteriale, si nga klientët ashtu edhe nga autoritetet rregullatore, Dhoma Kombëtare e Noterëve dhe Ministria e Drejtësisë. Në akte citohet se para noterit “i regjistruar në Dhomën e Noterëve (•) (ose Dega Vendore e Noterëve (•)), me zyrë në “Rr. (•)” (ose “Rr. (•)”), u paraqitën palët...”, çka lë të kuptosh ushtrimin e veprimtarisë në (•), rruga e (•).

I pyetur për të dhënë sqarime lidhur me këtë fakt, përfaqësuesi ligjor i noterit sqaroi se “Rr. (•)” do të thotë “Rrethi i (•)”, jo Rruga e (•). Në parashtrimet mbrojtëse, noteri shpjegon se “adresa e saktë e ushtrimit të aktivitetit noterial është Dega Vendore (•), Selia Rrethi – Bashkia (•)”.

Gjatë seancës dëgjimore përfaqësuesi ligjor pretendoi gjithashtu se noteri ushtron veprimtarinë e tij në një ndërtesë në ndërtim e sipër në aksin (•) – (•), ku ka adresuar edhe grupin e inspektimit të Ministrisë së Drejtësisë, sipas procesverbalit përkatës. Por, këto deklarime nuk gjejnë mbështetje në dokumentat zyrtare që i referohen veprimtarisë së noterit: kjo adresë nuk rezulton të jetë njoftuar pranë Ministrisë së Drejtësisë ose Dhomës Kombëtare të Noterisë dhe as nuk pasqyrohet në aktet noteriale të përpiluara nga vetënoteri, në të cilat vijon të shkruhet si adresë “Rr. e (•)”. Edhe fletënjohjet e dërguara nga Bordi Disiplinor në adresën aksi (•)– (•) nuk rezultojnë të nënshkruara nga noteri, por nga persona të tjerë.

Ende në ditën e kësaj vendimmarrjeje, adresa e veprimtarisë noteriale në ekstraktin e subjektit tregtar të noterit rezulton L. (•), (•), adresë ku ky aktivitet është inekzistent, të paktën prej datës (•), datë e procesverbalit të konstatimit mes përfaqësuesve të MD dhe përfaqësuesit të Dhomës Kombëtare të

Noterisë Dega (•), përmes së cilit vërtetohet se noteri nuk ka zyrë në qytetin e (•). Ndërsa, në akte noteriale vijon të citohet si adresë “Rr. (•)”.

Nga ana tjetër, me pak përjashtime, të gjitha aktet noteriale të përpiluara nga noteri dhe të administruara në dosjen hetimore rezultojnë të jenë hartuar me palë që kanë vendbanim në (•) dhe/ose për pasuri që ndodhen në territorin e Bashkisë (•). Noteri në parashtresën mbrojtëseshprehet se ky fakt nuk sjell pavlefshmërinë e aktit, sipas Ligjit. Por, ky deklarami noterit nuk merr në konsideratë kërkesat dhe procedurat e parashikuara nga Ligji për këtë qëllim: sipas nenit 70 të Ligjit 110/2018 “Për Noterinë”, veprimtaria noteriale mund të kryhet jashtë zyrës noteriale (i) për arsye të përligjura dhe (ii) duke përshkruar në akt në mënyrë të specifikuar vendndodhjen në të cilën është paraqitur noteri si dhe arsyen për të cilën e kryen veprimtarinë jashtë zyrës noteriale. Kushte këto që nuk janë verifikuar dhe plotësuar nga noteri.

Mosdeklarimi i adresës së saktë të zyrës në aktet noteriale, mospasqyrimi i adresës së pretenduar për ushtrimin e veprimtarisë (rruga (•) – (•)) në aktet noteriale dhe në regjistrat publikë, vendosja në aktet noteriale e adresës Dhoma e Noterisë (•), “Rr. (•)”, kryerja e veprimeve noteriale me palë me vendbanim në (•) ose për pasuri te paluajtshme që ndodhen në Bashkinë (•), pa respektimin e procedurave ligjore përkatëse, së bashku me deklaratat e noterit se jeton në Tiranë dhe evidencat e tjera të sipër përmendura, janë të gjithë elementë që **provojnë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se noteri nuk e ushtron veprimtarinë e tij në qytetin e Peshkopisë, por në Bashkinë e (•), në një adresë të paidentifikuar.**

Sa më sipër, përbën shkelje të neneve 17, 20 dhe 70 të Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë” si dhe të nenit 12 të Ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994 “Për Noterinë” (i shfuqizuar).

Mungesa e adresës në aktet noteriale (situatë me të cilën asimilohet edhe vendosja e një adresë të paidentifikueshme ose inekzistente si në rastin konkret) si dhe shkelja e kompetencës territoriale në përpilimin e akteve përbëjnë shkaqe për pavlefshmërinë e akteve publike, sipas Ligjit.

Sëdyti, lidhur me përmbushjen e detyrimeve tatimore, në shkresën e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të datës (•), e administruar në dosjen hetimore, evidentohet fakti se subjekti (•) me NIPT (•) ka qenë subjekt aktiv deri më datë (•) dhe se prej kësaj datë e në vazhdim ai rezulton të jetë pasiv. Shkresa informon, gjithashtu, se për periudhën që ka qenë aktiv, subjekti ka ende detyrime tatimore të pashlyera dhe se ka parregullsi me deklaramet për vitet (•) (rezulton se nuk ka dorëzuar deklaratëne kontributeve shoqërore dhe shëndetësore, deklaratën e tatimit mbi të ardhurat personale dhe deklaratën e tatimit për vlerën e shtuar për vitet në fjalë).

Nisur nga kjo shkresë, Bordi verifikoi statusin aktual të subjektit në momentin e procedimit disiplinor dhe rezultoi se subjekti (•) me NIPT (•) (NIPT me të cilin subjekti ushtron veprimtarinë si noter, sipas ekstraktit publik të QKR-së) është në listën e subjekteve tregtare që janë në regjistrin pasiv, në bazë dhe për efekt të nenit 44, prg. 7, i Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar. Nga të dhënat e kësaj liste, Bordi konstatoi se subjekti i procedimit z. (•) rezulton të jetë subjekt me status “pasiv” qysh prej datës 24.09.2012.

Sipas ligjit, një subjekt transferohet nga regjistri aktiv në regjistrin pasiv në rast se përmbushet, të paktën, një nga kushtet e mëposhtme:

1. nuk ushtron më veprimtari tregtare për një periudhë tatimore prej 12 muajsh të njëpasnjëshëm;
2. nuk dorëzon deklaratën tatimore për një periudhë tatimore prej 12 muajsh të njëpasnjëshëm;
3. deklaron në QKB pezullim veprimtarie tregtare dhe paguan të gjitha detyrimet tatimore.

Pra, rezulton se noteri për një periudhë të gjatë dhe të pandërprerë, prej pothuajse 9 (nëntë) vitesh, ndodhet në një prej situatave të parashikuara si më sipër, të cilat evidentojnë shkelje të vazhdueshme të detyrimeve tatimore e që janë të papajtueshme me veprimtarinë e noterit, si nëpunës publik.

Vlen të theksohet fakti se, pavarësisht fillimit të hetimit disiplinor nga Ministria e Drejtësisë dhe zhvillimit të këtij procedimi disiplinor përpara Bordit, noteri ka treguar indiferencë dhe shpërfillje ndaj përmbushjes së detyrimeve bazë për ushtrimin e veprimtarisë së Noterit në Republikën e Shqipërisë. Ai ka vijuar me mospërmbushjen e detyrimit të njoftimit të adresës së saktë të ushtrimit të veprimtarisë, si pranë autoriteteve rregullatore ashtu edhe në aktet noteriale të përpiluara prej tij, si dhe me mospërmbushjen e detyrimeve tatimore, pavarësisht faktit se ka vijuar me përpilimin e akteve noteriale publike dhe përfitimin e të ardhurave përkatëse.

Bordi vlerëson se shkeljet e mësipërme janë të natyrës së rëndë, të papajtueshme me veprimtarinë e noterit, si nëpunës publik dhe garant i ligjshmërisë së akteve dhe veprimeve juridike.

Së treti, vërehet se nga regjistrimi i noterit në QKB rezulton se emri i tij është deklaruar dhe shënuar (•), ndërkohë kur në letërnjoftimin e tij është shënuar (•) dhe në aktet noteriale të përpiluara prej tij është shënuar (•). Kjo dëshmon se noteri është treguar më shumë se sa i pakujdesshëm për të saktësuar në radhë të parë emrin e tij dhe tregon njëkohësisht edhe indiferencën dhe neglizhencën e tij. Kjo pasaktësi u evidentua edhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore pranë Bordit dhe megjithëse procedimi disiplinor vijoi për më shumë se dy muaj, përsëri emri i noterit në QKB nuk u korrigjua asnjëherë prej tij.

Së katërti, lidhur me shkeljet e tjera të pretenduara nga Ministria e Drejtësisë, sa i përket rregullshmërisë së organizimit të veprimtarisë noteriale, pasi dëgjoi argumentat e përfaqësuesit ligjor të subjektit të procedimit, Bordi vlerëson se:

Noteri nuk provoi se zotëron llogari bankare të dedikuara për ushtrimin e veprimtarisë noteriale si person fizik tregtar dhe pranoi se nuk zotëron llogari bankare kalimtare (escroë) dhe as kontratë sigurimi profesional. Bordi vlerëson se nuk qëndrojnë argumentet e noterit sa i përket faktit që sigurimi profesional dhe pajisja me llogarinë kalimtare të dedikuara nuk janë të detyrueshme. Ligji për Noterinë, respektivisht në nenet 65 dhe 68 të tij, përcakton qartësisht detyrimet e noterit në këtë drejtim.

Nuk qëndron gjithashtu argumenti i noterit për mos-hedhjen e akteve në RNSH për shkak të pamundësisë objektive: nëse ekzistonin shkaqe të pamundësisë objektive, noteri duhet t'ia kishte njoftuar paraprakisht ato Ministrisë së Drejtësisë, si autoritet që administron Regjistrin RNSH, ndërkohë që numri i akteve të pahedhura në RNSH nuk është sporadik por në nivele të konsiderueshme.

Së pesti, lidhur me pasaktësitë e pretenduara në përpilimin e akteve, Bordi vlerëson se:

Noteri, në (•) raste, ka shkelur dispozitat ligjore për çeljen e trashëgimise dhe lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë. Konkretisht, në aktet noteriale me Nr. (•) Rep., Nr. (•) Kol., datë (•), "Vendim për lëshim dëshmi trashëgimie ligjore", noteri ka lëshuar dëshmi trashëgimie për trashëgimlënës me banim në Tiranë, në kundërshtim me nenin 348 të Kodit Civil, i cili parashikon se "Dëshmia e trashëgimisë ligjore lëshohet nga noteri i njësisë vendore ku ka pasur vendbanimin e fundit trashëgimlënësi". Gjithashtu, nga verifikimi aktit Nr. (•) Rep., Nr. (•) Kol., datë (•) "Vendim për lëshim dëshmi trashëgimie testamentare", rezulton se testatori ka qenë me vendbanim në Tiranë dhe po ashtu pasuria e tij ndodhej në Tiranë; për pasojë veprimi i kryer nga noteri është në kundërshtim me nenin 318/1 të Kodit Civil që parashikon se "Trashëgimia celet në vendin ku ka patur vendbanimin e fundit trashëgimlënësi. Kur vendbanimi i fundit i trashëgimlënësit nuk dihet, trashëgimia çelet në vendin ku ndodhet e gjithë pasuria ose pjesa kryesore e saj".

Lëshimi i dëshmive të trashëgimisë jashtë kompetencës vendore, siç ka rezultuar në rastet e analizuara, përbën shkelje disiplinore të rëndë, me pasojë të mundshme lidhur me vlefshmërinë e aktit publik të përpiluar.

Vërehen edhe parregullsi të tjera lidhur me emërtimin e saktë të veprimeve juridike, që mund të behen pengesë për zbatimin e saktë të dispozitave ligjore përkatëse dhe realizimin e qëllimeve të palëve: psh. disa prej akteve të emërtuara "akt noterial për kalimin e pasurisë së paluajtshme" (Nr. (•) Rep., Nr. (•)

Kol., datë (•)) apo “ Akt noterial për kalimin në pronësi të pasurisë së paluajtshme “ (Nr. (•) Rep., Nr. (•)Kol., datë (•)) sinonin realizimin e efekteve ligjore të dhurimit.

Bordi vlerëson se, në kushtet e administrimit nga subjekti i procedimit të akteve noteriale ku rezultonte aplikimi i pullës në faqen e fundit të fletës së fundit të çdo akti, nuk do të marrë në konsideratë në vlerësimin e tij këtë shkelje të pretenduar nga Ministria e Drejtësisë.

Gjithashtu, Bordi vlerësoi të mos marrë në konsideratë as rezultatet e dy inspektimeve administrative të mëparshme, konkretisht inspektimit të kryer në bazë të Urdhërit Nr. (•), datë (•) dhe Urdhërit Nr. (•), datë (•) të Ministrit të Drejtësisë, duke qenë se këto kontrole / hetime administrative nuk janë objekti i këtij procedimi disiplinor.

Bazuar në nenin 26 të Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë” **“Shkeljet disiplinore dhe masat kundër noterit”**:

1. Noteri kryen një shkelje disiplinore në rastet kur:

a) vepron në kundërshtim me dispozitat ligjore ose nënligjore;

b) kryen veprime ose mosveprime që janë në kundërshtim me Kodin e Etikës Profesionale dhe që cenojnë rëndë besimin e publikut në sistemin noterial;

c) shkel detyrimet ligjore të anëtarit të Dhomës të parashikuara në këtë ligj.

3. Masa disiplinore e dhënë ndaj një noterit jepet në proporcion me shkeljen dhe bazohet në kriteret e mëposhtme:

a) shkallën e pakujdesisë;

b) shpeshtësinë e kryerjes së gabimit;

c) probabilitetin dhe rëndësinë e dëmit të mundshëm nga shkelja;

ç) çdo situatë që është jashtë kontrollit të noterit dhe që mund të shpjegohet në mënyrë të arsyeshme;

Me veprimet dhe mosveprimet e tij sistematike dhe të vazhdueshme në vite, Noteri ka shkelur dispozita ligjore urdhëruese në fushën e organizimit dhe funksionimit të shërbimit të noterisë në Republikën e Shqipërisë, në fushën e tetimeve dhe si dhe dispozita urdhëruese të Kodit Civil.

Noteri ka vijuar të veprojë në shkelje të dispozitave të mësipërme prej një kohe të gjatë dhe nuk ndërmori asnjë veprim për rregullimin e situatës së tij edhe pas fillimit të hetimit dhe procedimit disiplinor, në indiferencë dhe shpërfillje të situatës dhe shkeljeve të evidentuara. Veprimet dhe mosveprimet e tij janë në shkelje shumë të rëndë të Ligjit dhe janë të papajtueshme me veprimtarinë e noterit si nëpunës publik, që duhet të garantojë një nivel të lartë të ligjshmërisë, sigurisë juridike dhe përgjegjshmërisë ndaj pasojave për të tretët.

PËR KËTO ARSYE,

Bordi Disiplinor, Dhoma Kombëtare e Noterisë, mbështetur në nenin 51, pika 2, të Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë” dhe nenin 11 të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë Nr. 170, datë 10.06.2020 “Për miratimin e rregullores dhe skemën e kompensimit dhe funksionimin e Bordit Disiplinor”

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës të Ministrisë së Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj Noterit (•);
2. Lënien në fuqi të masës disiplinore të propozuar nga Ministri i Drejtësisë, sipas nenit 26, pika 2, gërma “dh”, të Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë”;
3. Heqjen përfundimtare të licensës për ushtrimin e profesionit të noterit (•);
4. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë për nxjerrjen e urdhrit përkatës për zbatimin e këtij vendimi;
5. Ngarkohet Dhoma Kombëtare e Noterisë për publikimin e këtij vendimi dhe regjistrimin e tij në regjistrin e masave disiplinore, në zbatim të neneve 54 dhe 55 të Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë”;

6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatën administrative të shkallës së parë Tiranë, brenda 45 diteve nga e nesërmja e komunikimit të këtij vendimi;
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

U shpall, më datë (•), në Tiranë.

Bordi Disiplinor:

Jonida Gaba

Entela Memishaj Shehaj

Irena Laha

Marjana Tutulani Semini

Merita Prifti